



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Procesverbal i Mbledhjes së IV-të të KMCV

Nga mbledhja e dytë e KMCV mbajtur më 16.09.2021 me fillim në orën 13.00

Salla A/11, UKZ

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i KMCV Prof.Asoc.Dr. Xhevdet Thaqi, i cili për kë takim propozoi këtë:

Rend Dite

1. Fillimi i vitit të Ri Akademik
2. Vlerësimi i stafit Akademik nga ana e studentëve
3. Rishikimi i programeve studimore
4. Të ndryshme

Të pranishëm në takim ishin prezent të gjithë anëtarët e KMCV-së

Propozimi i rendit të ditës u hodh në votim dhe u miratua unanimisht nga anëtarët e KMCV

Lidhur me pikën 1.Kryesuesi Prof. Asoc. Dr. Xhevdet Thaqi, theksoi se janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për fillimin e veitit të ri akademik. Në vazhdim theksoi se është hapur konkursi për angazhimin e stafit akademik për vitin 2021/22, janë akredituar programet e reja baçelor dhe master si dhe jena në përgatitje të ri akreditimit dhe akreditimit të ri për programin Matematikë Arsimore në nivelin baçelor dhe Master.

Kryesuesi potencoi se përkundër angazhimeve të shumta për fillimin e vitit akademik ashtu siç është paraparë, për shkak të gjendjes së rënduar pandemike dhe masave anti covid nga IKSHP dhe Ministria e Shëndetësisë , është e mundur që ky vit akademik të filloj më 15 tetor 2021

Lidhur me pikën 2 kryesuesi i KMCV ia dha fjalën drejtoreshës së ZZHA Znj. Fitore Malaj_Avdyli, e cila njoftoi anëtarët e KMCV me rezultatet e vlerësimit të stafit akademik për vitin 2020/21 në dy nivelet e studimit. Në vazhdim theksoi se kemi vonesa në publikimin e këtyre rezultateve sepse kanë munguar disa të dhëna. Njëherit ajo theksoi se këto tabela janë në nivel të UKZ ndërsa përpunimin e rezultateve të vlerësimit në nivel të njësive akademike do ta bëjnë Koordinatorët e njësive akademike Ajo pas një elaborimi të detajuar të këtyre rezultateve hapi diskutimin lidhur me këtë pikë.

Studentja X....., tha se pajtohet me këto rezultate të vlerësimit mirëpo, duhet theksuar se studentët të cilët janë me rezultate të mira japin vlerësim të ndryshëm nga ata që janë me rezultate të dobëta dhe se kjo mund ta jep një pasqyrë joreale të vlerësimit.

Refik Ibrahim, propozoi që të shtohet edhe një formë e vlerësimit të mësimdhënësve në SMU , ku studentët e diplomuar me rastin e aplikimit për lëshimin e diplomës të plotësojnë formularin për vlerësimin e mësimdhënësve sepse kjo do të ishte mënyra më e mirë për të bërë krahasime me këto vlerësime që kemi aktualisht.

Pas një diskutimi anëtarët e KMCV unanimit miratuan raportin e vlerësimit të mësimdhënësve për vitin akademik 2021/22

Lidhur me pikën 3 të rendit të ditës, Kryesuesi i KMCV Prof.Asoc.Dr. Xhevdet Thaqi, tha se stafi akademik në mënyrë permanente duhet rishqyrtuar programet studimore si dhe syllabusët. Kjo duhet kërkuar nga dekanatet e njësive akademike dhe në koordinim me koordinatorët e cilësisë vazhdimisht të azhurnohen të dhënat në ueb faqen zyrtare

Ai në vazhdim kërkoi nga njësit akademike që të zbatojnë vendimin e Senatit ku kërkohet që të gjitha njësit akademike të UKZ në planet e tyre mësimore të fusin lëndët TIK dhe Shkrim akademik.

Bashkim Dalipi, tha se ne si dekanat kemi vërejtje për mënyrën e lejimit të afatit të nëntorit për arritje të kushtit sepse për shkak të këtij problemi po kalon semestri dimëror dhe ne nuk po kemi qasje në numrin real të studentëve dhe kështu nuk po mundemi të planifikojmë ndarjen e grupeve apo përcaktimin për lëndë zgjedhore.

Xhvedet Thaqi, tha se afati i nëntorit nuk pengon ne planifikim sepse ata që presin këtë afat të provimeve janë në numër të vogël.

Fatmire Krasniqi, Tha se kemi vërejtur që syllabusët e reja që kemi pasur në ueb faqe janë hequr dhe ato të vjetrat kanë mbetur në ueb faqe, kjo duhet të shikohet në zyrën e TI pse ka ndodhur.

Shefket Jakupi, Tha se Fakulteti Ekonomik ka rifreskuar të dhënat në SMU por disa janë hequr kur SEMS ka kaluar në SMU

Refik Ibrahim, kërkoi që njësit akademike të përgatisin shënimet e stafit të angazhuar (syllabuset, fotografimin e stafit ,punimet shkencore dhe CV-it e tyre) dhe të njëjtat të publikohen te stafi akademik i njësisë përkatëse akademike

Bashkim Dalipi, Tha se sa i përket syllabusëve ne ato i kemi në RVV dhe kërkoj të di se a kanë të drejtë të ndryshojnë diçka.

Fitore Malaj-Avdyli, tha se ka një model të syllabusit dhe se atë model ju ka dërguar dekanëve të njësive akademike.

Xhevdet Thaqi, tha se duhet të hartohet një raport nga njësitë akademike dhe t'i dorëzohet KMCV nga ku do të dalin rekomandimet për përmirësime të cilat pastaj do t'i dorëzohen menaxhmentit

Ai në vazhdim kërkoi që të promovohet bashkëpunimi dhe të ndihmohet publikimi dhe hulumtimi

Në pikën 4 u kërkua që n rregulloren për të ardhura personale të futet konpenzimi për anëtarët e KMCV

Psi që diskutime tjera nuk pati mbledhja përfundoi në orën 15.30

Procesmbajtësi

Refik Ibrahim

Kryesuesi i KMCV

Prof. Asoc. Dr. Xhevdet Thaqi